

**AKT - THEMELIMI  
( KONTRATE )  
I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE  
KUFIZUAR**

**ILIRIA ' 98 Sh.p.k.**

Une, Ndririm Shehaj , I biri i Qamilit , i dtl.1947, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane , Rr. Shemsi Haka , Nr. 58/1 . Ne baze te legjislacionit shqipetar vendosa :

**Neni 1**

Te themeloj nje shoqeri tregetare me pergjegjesi te kufizuar per te ushtruar veprimtarine ekonomike e emeruar **ILIRIA ' 98 Sh.p.k. me ortake te vetem Z.Ndririm Shehaj** .

**Neni 2**

Shoqeria do te jetet e formes se Shoqerive tregetare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbiet deri ne kufirin e vleres te derdhur ne kapitalin themelor.

**Neni 3**

Shoqeria e ka seline e saj, ne qytetin e Tiranes , Rr. Shemsi Haka , Nr. 58/1 Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

**Neni 4**

Shoqeria do te kete nje kohezgjatie me nje kufi te percaktuar mbi 10 vjet. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te ortakut te vetem.

**Neni 5**

Kapitali fillestar themelor I Shoqerise do te jetet 2.500.000 ( dy milion e peseqin mijë ) leke, kapital I cili eshte I formuar teresisht nga ortaku i vetem themelues i saj.

**Neni 6**

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregetare do te shenohet dhe kapitali I derdhur nga ortaku.

Rritja e kapitalit te ortakut nuk eshte e kufizuar.



Neni 7

Te gjitha pjeset e kapitalit themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaku I vetem I Shoqerise.

Neni 8

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jetë :

**Kembime valutore .**

Neni 9

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne mbeshtetie te ligjit Nr. 7961, date 12.07.1995 ( Kodit te Punes ), si dhe akteve te tjera nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Neni 10

Ortaku I vetem nuk kufizohzt ne rritjen e kapitalit te shoqerise .

Neni 11

Shoqeria vepron ne rregjimin e prones private dhe merr persiper te drejtë e detyrime vetem brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortaku I vetem themelues mbart rrezikun e veprimtarise se Shoqerise vetem ne nivelin e kapitalit te investuar ne Shoqeri.

Neni 12

Mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private te shoqerise midis punonjesve brenda saj, si dhe me te tretet, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim , ceshtia mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit te Tiranes, ku do te jetë dhe rregjistri tregetar I saj .

Neni 13

Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit te saj.

Neni 14

Pasuria e shoqerise mund te sigurohet prane Institutit te Sigurimeve Shoqerore.

Neni 16

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me mbarimin e afatit te percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortaku .

**Neni 17**

Organet e shoqerise ILIRIA ' 98 sh.p.k. jane :

Ortaku I vetem I shoqerise .

Administratori I shoqerise .

Komisioni I eksperteve kontabel .

Modalitete e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutitn e shoqerise .


Administrator I shoqerise do te jetë , **Z. NDRICIM SHEHAJ** .

Modalitete per ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga Statuti I Shoqerise dhe ligji 7638 date 19.11.1992 " Per Shoqerite Tregetare " .

Ky Akt - Themelimi eshte perpiluar ne kater kopie me vlore te njejtë me origjinalin .

Tirane me , 18/02/1998

**THEMELUES : NDRICIM SHEHAJ**



## S T A T U T

### I SHOQERISE TREGTETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

#### ILIRIA '98 SH.P.K.

Shoqeria **ILIRIA '98** eshte e krijuar mbi bazen e Akt-themelimit te Ortakut te vetem, Ndricim Shehaj , i biri i Qamilit , i dtl. 1947, lindur ne Gjirokaster dhe banues ne Tirane , Rr. Shemsi Haka , Nr. 58/1 , qytetar Shqipetar, per te zhvilluar aktivitet tregetar ne fusha te ndryshme, i cili ka vendosur te perpilojne kete Statut si me poshtë:

#### Neni 1                    EMERTIMI

Shoqeria eshte quajtur **ILIRIA '98 Sh.p.k.**

Ajo eshte nje subjekt juridik Shqipetar, te cilit i lind e drejte te ushtroje aktivitetin qe nga data e Rregjistrimit ne Rregjistrin tregetare prane Gjykates se Rrethit Tirane.

Shoqeria **ILIRIA '98** zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqipetar dhe me aktet e themelimit te saj (Akt - Themeli dhe Statuti). Shoqeria e ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire. Ortaku I vetem themelues ne kete sipermarrie ka derdhur kapitalin e tij, me qellim qe te perfitoj te ardhura, qe mund te vijne nga ushtrimi I veprimtarise private, si dhe te perballoj humbiet deri ne kufirin e vleftes se derdhur ne kapitalin themelor.

#### Neni 2                    OBJEKTI

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jetë :

**Kembime valutore .**

#### Neni 3

Per kryerien e veprimtarise se saj Shoqeria do te hapi njesi grumbulluese, perpunuese, sherbimi e tregetimi, duke bashkepunuar me persona fizike ose juridike, vendas ose te huaj .

#### SELIA

Shoqeria **ILIRIA '98** e ka seline e saj, ne Tirane ,Rr. Shemsi Haka , Nr. 58/1

Ajo ka te drejte te krijoje brenda dhe jashte teritorit te Republikes se Shqiperise, filiale, agjensi perfaqesi, seli sekondare si dhe ti suprimoje ato.

#### **Neni 4**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

Shoqeria Tregetare Private **ILIRIA '98 sh.p.k.** do te kete nje kohezgjatje te veprimtarise se saj ekonomike me nje afat te pacaktuar, e mbi 10 vjet dhe mund te shperbehet ne cdo kohe per cfaredo shkaku.

#### **Neni 5**

#### **KAPITALI I SHOQERISE**

Kapitali fillestar I shoqerise eshte 2.500.000 leke, e perbere nga kuota e ortakut te vetem themelues. Kapitali themeltar I shoqerise formuar teresisht nga themeluesi I saj **Ndricim SHEHAJ**.

#### **Neni 6**

Pjeset e kapitalit themelor jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie, ne rast ndarie pasurore ndermjet bashkeshorteve, paraardhesve e pasardhesve. Ne rast vdekie te ortakut pjesa e kapitalit qe disponon kalon te trashegimtaret e tij dhe kur asnjeri nga pjesetaret e families nuk pranon te punoje ne ortakeri, atehere u jepen te gjitha fitimet qe u takojne sipas kontributit te derdhur ne kapitalin themelor.

Te gjitha pjeset e kapitalit te Shoqerise mund tu kalojne, tu transferohen personave te trete, qe nuk bejne pjese ne ortakeri, por gjithmone me vendim te ortakut te vetem dhe me akt notarial .

Trashegimtari hyn ne Shoqeri me te gjitha te drejtat e ortakut dhe me te gjitha efektet.

#### **Neni 7**

Kapitali I shoqerise perbehet nga kapitali themelor, mjetet e xhiros, dhe te tjera te nevojshme per ushtrimin e veprimtarise tregetare . Te gjitha pjeset e kapitalit themelor themelor jane teresisht te shlyeshme dhe te nenshkrueshme nga ortaku I vetem I shoqerise .

#### **Neni 8**

Fitimi I realizuar nga ushtrimi I veprimtarise ekonomike I Shoqerise do te administrohet nga ortaku I vetem . Nje pjese te ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregetar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyej te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te treteve .

## Neni 9

Shoqeria eshte perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo mund te bleje te drejta te tjera materiale ose jo materiale, duke perfshire edhe te drejten per shitjen e pasurise se vet tek te tjere, te tretet.

Ne R.SH. Shoqeria Tregetare **ILIRIA '98 SH.P.K.** gezon te drejta sikunder cdo person tjeter juridik ose fizik shqiptar ose I huaj ne perputhje me legjislacionin shqipetar ne fuqi.

## Neni 10

### ORGANIZIMI DHE ADMINISTRIMI NE SHOQERI

Organi vendimor jane vendimet e ortakut te vetem qe zevendeson Asamblene e Ortakeve .

Ortaku I vetem ka te gjitha te drejtat qe ka Asambleja e Ortakeve.

Ortaku I vetem vendos per ceshtie te tilla, si emerimi ose shkarkimi I administratoreve, eksperteve kontabel te autorizuar dhe likujduesve, miratimi I raporteve te administrimit dhe kontrollit, miratimi I llogarive, ndaria e fitimit, ndryshimet ne Statut, zgogrimi I kapitalit themelor, ose zmadhimi I tij, transferimi I pjeseve te kapitalit themelor tek te tretet, zgjatia e afatit te veprimtarise se Shoqerise apo likujdimi I saj, shnderrimi I Shoqerise ne nje forme tjeter, ne nje nga format e parashikuara nga ligja ne formen e kerkuar sipas ligjes, ndryshimi I vendqendrimit te selise.

## Neni 11

Ortaku I vetem mbledhiet e zakoneshme I ben cdo vit brenda kater muajve, nga mbyllja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise

## Neni12

### ADMINISTRATORI

Administratori qendron per nje periudhe 3 vjecare ne detyre.

Mandati I tij mund te jete I rrinovueshem. Ortaku gezon te drejten ne cdo kohe te shkarkoje nga detyra administratorin dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij. Administratori mundet ne cdo moment te emeroje nje zevendes, ta revokoje dhe te emeroje nje tjeter ne vend te tij.

Administratori ka keto kompetencia:

Percaktimin e orientimeve kryesore te programit dhe buxhetit

Aprovimin e planeve dhe te llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne baze te objektit te aktivitetit te shoqerise

Percaktimin e propozimeve dhe variantave te kapitalit qe do ti paraqiten ortakut te vetem

Percaktimin e organikes drejtuese

Kijimin e organizmave te tjera per realizimin e objektivave dhe funksioneve te shoqerise  
Parapergatitjen e propozimeve per nderprerjen e aktivitetit te shoqerise  
percaktimin e kerkesave te financimeve.

Neni 13

Administratori parashikon brenda 31 marsit perfundimin e bilancit dhe llogarise ekonomike duke ia paraqitur ortakut te vetem per miratim.

Neni 14

### **VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE DHE REZERVA E DOMOSDOSHME**

Cdo vit finanziar fillon me 1 Janar te cdo viti dhe perfundon me 31 Dhjetor, me perjashtim te vitit te pare, ku si fillim eshte data e rregjistrimit te shoqerise.

Neni 15

Llogarite vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit finanziar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratoret, apo nga ekspertet kontabel miratohen nga ortaku I vetem . miratimi I dokumentave financiare vjetore behet brenda nje afati 3 - mujor, mbas dates se shlyeries te vitit finanziar, te mbyllies se vitit finanziar.

Neni 16

Mbas miratimit te llogarive vjetore dhe vertetimit te ekzistences se fitimit, ortaku I vetem vendos e krijon fondin ligjor, por mund te krijoje edhe fonde te tjera.

Shoqeria per gjigjet per kontributin fiskal, afatet e derdhies se sigurimeve shoqerore, etj . Ajo ka te drejte te celi llogari likujduese prane bankave te vendit dhe te kryej veprime likujdimi me to .

Neni 17

### **MARREDHENIET E PUNESIMIT DHE LIDHJA E KONTRATAVE**

Marredheniet e punesimit brenda Shoqerise rregullohen nepermjetkontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin Nr. 7961, date 12.07.1995 ( Kodi I Punës ), si dhe legjislacionit tjeter shqipetar qe ben fjale per punesimin .

Neni 18



Marria ne puna behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne librin e punes Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e punes te juridikzionit ku ushtron veprimtarine Shoqeria .

#### Neni 19

Largimi nga puna behet me mbarimin e kontrates se punes, per shkelie disiplinore, ose me vete kerkesen e te interesuarit .  
largimi nga shoqeria behet mbasi jane shlyer te gjitha detyrimet materiale dhe monetare .  
Ndryshimi dhe largimi nga vendi I punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga ortaku I vetem themelues .

#### Neni 20

Shoqeria mund te lidhi kontrata me sektore shteterore, drejtperdrejt ne tregun e lire, si dhe me persona fizike ose juridike, vendas ose te huaj.  
Ne veprimet kontraktuale Shoqeria perfaqeshet nga ortaku I vetem I saj, ose nga nje person tjeter I autorizuar prej tij me prokure .  
Te drejtat e detyrimet qe rrjedhin nga kontratat jane te detyrueshme per shoqerine .

#### Neni 21

#### DISPOZITA TE TJERA TE PERGJITHESHME

Shoqeria mund te prishet para afatit te caktuar ne kete Statut, ne rastet kur ndryshon afati ose kur ka nje prishie te parakohshme per shkaqe te tjera .

#### Neni 22

Shoqeria hyn ne procesin e likujdimit qe ne momentin e prishies se saj . per kryerien e ketij procesi emerohen nje ose disa likujdatore te cilet ndjekin operacionet e likujdimit deri ne fund dhe I paraqesin ortakut te vetem dhe administratorit rezultatet perfundimtare te likujdimit . Ne perfundim ortaku I vetem vendos per heqien e mandatit te tyre . te gjitha detyrimet qe dalin nga likujdimi ortaku I vetem dhe administratori I merr persiper per ti shlyer me kapitalin e tij.

#### Neni 23

Te gjitha mosmarreveshiet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise se Shoqerise kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, do te kalojne ne kompetence te Gjykates se Rrethit Tirane ku eshte edhe rregjistri Tregetar I Shoqerise .



Neni 24

Ceshtie te tjera te patrajtuara ne kete Statut do te mbeshteten per zbatim ne legjislacionin shqiptar ne fuqi, sipas rastit konkret, si te ligjit Nr. 7512, date 10.08.1991, Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 .

Neni 25

Ndryshimi I Shoqerise ne nje Shoperi tjeter behet me vendim te ortakut te vetem, kur plotesohen kushtet per krijimin e Shoqerive te llojeve te tjera .

Neni 26

Themeluesi I Shoqerise mund te beje ndryshime e plotesime ne Statut dhe ne aktin e themelimit pa rene ndesh ne menyre thelbesore ne cdo kohe , me nenet e pershkruara ne kete Statut .

Ndryshimet e plotesimet behen ne te njejten menyre e procedure me te cilin nxirret vete statuti .

Neni 27

Ceshtjet e tjera qe nuk jane trajtuar ne kete statut , gjithshka I referohet Ligjit Nr. 7638, date 19.11.1992, Ligjit Nr. 7667, date 28.01.1993 si dhe legjislacionit shqipetar ne fuqi, si dhe akteve te tjera ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre .

Neni 28

Ky statut eshte perpiluar dhe firmosur ne kater kopje me vlore te njejtë me originalin.

Tirane , me 18.02.1998

**ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**NDRICIM SHEHAJ**